U D H Ë Z I M
Nr.2, datë 10.2.2004

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 8.1.2003 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.9158, datë 18.12.2003 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Financave,

UDHËZON :

Pika 21 e udhëzimit nr.2, datë 8.1.2003, ndryshohet si më poshtë :

21. Taksa e qarkullimit rrugor

Taksës së qarkullimit rrugor i nënshtrohen të gjitha mjetet e klasifikuara, sipas ligjit, të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë vilet nga qëndrat e kontrollit teknik të drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, para kryerjes të kontrollit teknik me të parë (kontrollit teknik vjetor apo periodik). Vlera e taksës është e njëjtë, pavarësisht nëse ajo vilet në gjashtëmujorin e parë apo të dytë të vitit dhe pagesa e saj shoqërohet nga një biletë me numër serial, që lëshohet nga agjenti tatimor. Mjetet e reja, që targohen dhe kryejnë kontrollin teknik për herë të parë do të paguajnë taksën e plotë në momentin e kryerjes së kontrollit teknik vjetor.

Gjatë kryerjes së kontrollit periodik zotëruesi i mjetit është i detyruar që krahas dokumentit të pagesës së taksës së tonazhit për aks të paraqesë edhe pagesën e taksës së qarkullimit rrugor.

Drejtoritë rajonale në rrethe brenda muajit janar dërgojnë në degët e tatimeve mjetet që janë të regjistruara për kontrollin teknik të detajuara sipas strukturës së tyre.

Çdo muaj drejtorite rajonale evidentojnë dhe dërgojnë në degët e tatimeve në rrethe listën e mjeteve që duhet të paguanin taksën dhe mjetet që e kanë paguar taksën.

Në fund të çdo muaji degët e tatimeve me drejtoritë rajonale bëjnë akt rakordimi për numrin e mjeteve që kanë paguar taksën, sipas strukturës së mjeteve.

Përjashtohen nga pagesa e taksave mjetet në pronësi të veteranëve dhe invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, të invalidëve të punës, si dhe të të verbërve dhe të të sëmurëve paraplegjik dhe tetraplegjik

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj